

Fjala e Prorektore Prof. Ass. Dr. Shpresë Qamili

Përsëritje për të gjithë të pranishmit,

Me 6 vite e tij, me 6 vitet e nismës, të ecjes dhe të rritës të tij, Universiteti “Kadri Zeka” në Gjilan, tashmë ka krijuar një traditë të mirë, të fortë dhe të suksesshme të arsimit të lartë në rajonin e Anamoravës, sepse kjo traditë është vazhdimësi e zhvillimit të suksesshëm, traditë gjysmëshekullore arsimit të lartë në Gjilan dhe në rajonin e Anamoravës.

6 vjet të universitetit tonë, ndoshta edhe nuk janë vite që paraqesin një numër që do të duhej shquar për t’u konsideruar dhe për t’u barazuar me të tjerët, në aspektin numerik, por për këtë pjesë të Kosovës, e cila shquhet historikisht për dëshirën, vullnetin, entuziazmin dhe qëndrueshmërinë e pathyeshme për t’u arsimuar, përvjetorët e tillë dosido se shënojnë emnesë të veçantë, aq më parë kur tek ne arrijtjet në sferën e edukimit, të dijes, të kulturës, të artit dhe të shkencës, pa zmadhimin më të vogël, kanë zënë dekadat e universiteteve të tjera, jo vetëm në viset shqiptare, madje në aspektin e cilësisë, padyshim kanë tejkaluar mundësitë dhe pritjet. Dhe, njëmendi kemi zënë dhe i kemi tejkaluar të tjerët, sepse jemi përhapës cilësorë të rrezatimit kulturor, civilizues, arsimor, artistik e shkencor në Republikën e Kosovës.

Universiteti “Kadri Zeka” i Gjilanit, tashti në rrafshin kombëtar, duke trashëguar një përvojë pesëdekadëshe të nivelit të arsimit të lartë, me gjithë krajetat, ngritjet dhe rëniet, përpjekjet dhe pengesat, është duke ecur drejt një konsolidimi të plotë në të gjitha segmentet akademike. Dhe, vazhdimisht janë duke u bërë përpjekjet për arritje sa më të lartë. Duke pasur parasysh të gjitha rrethanat, të gjitha vështirësitë, angazhimi i gjithë personelit, akademik dhe jo akademik, është në përputhje të plotë me vizionin dhe misionin e Universitetit. Madje, ky angazhim dhe kjo përpjekje, jo rrallë, kapërcejnë edhe kufijtë realë të mundësive, duke mbërthyer brenda vetes edhe një lloj entuziazmi, që aktualisht na duket më se i nevojshëm, për të bërë hapa edhe më të sigurt drejt konsolidimit të plotë të punës sonë akademike.

Për më shumë, duhet theksuar se vetë qyteti i Gjilanit, si një qendër tashmë e stabilizuar e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës, duke qenë një

udhëkryq ndërlidhës i rajoneve shqiptare (Gjilan – Preshevë – Kumanovë), të ndara në tri shtete, hapësirën gjeografike të tij do ta shfrytëzojë si një pikë afrimi të të rinjve të këtyre rajoneve shqiptare për të mësuar dhe për t'u arsimuar në drejtime të ndryshme, në gjuhën e tyre të përbashkët - shqip.

Ju faleminderit.

Shpresë Qamili-Prorektore